



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1731/1 prot.,

Datë 03.07.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TOWER” SHPK në Minikonkursin me objekt: **“Mbikqyrja e punimeve për “Ndërtim i ri të shkollës dhe repartit të shkollës Pavarësia Vlorë”** sipas Ftesës për Ofertë me Nr. 1792/2 prot., datë 09.06.2025”, e zhvilluar në datën 12.06.2025, në lidhje me procedurën e prokurimit “*Shërbim – e hapur mbi kufirin e larte monetar (Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara*” me nr. REF-37091-02-07-2025, me objekt: “*Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit*”, *Marrëveshje Kuadër me disa operator ekonomik me kushte të pa përcaktuara, me afat 12 muaj*”, me fond limit 120,182,651 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 03.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “TOWER” SHPK me NIPT L21717003H dhe adresë Njesia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara me adresë
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë
(në krah të Gjykatës së Lartë).

Në datën 01.07.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/55001 dhe me nr. 1731/2025 prot., datë 02.07.2025 e operatorit ekonomik “TOWER” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TOWER” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”*, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “TOWER” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“OE: “TOWER” shpk, me NIPT L21717003H ka paraqitur inxhinier rezident për këtë objekt ing. Irdi Kulla. Nga verifikimi i dokuemntacioni të paraqitur në marrëveshjen kuadër rezulton se ing. Irdi kulla nuk është pjesë e stafit teknik të deklaruar nga ky OE në dispozicion të kontratave që do të fitohen me minikonkurime. Për këtë arsye OE skualifikohet”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 03.07.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**Anëtar****Kreshnik Ternova****Anëtar****Gjergj Mersini****Nënkryetar****Fiorent Zguro**